



NJOFTIM PËR MEDIA

21 shtator 2020

Lansohet online raporti: *Ku janë paratë për të drejtat e grave? Trendet e financimit në Ballkanin Perëndimor*

Nesër, më 22 shtator 2020 në orën 10:00, [Fondacioni Kvinna till Kvinna](#) do të lansojë raportin [Ku janë paratë për të drejtat e grave? Trendet e financimit në Ballkanin Perëndimor](#). Ngjarja do të mbahet online dhe është e hapur për publikun përmes platformës [Zoom](#).

Sado që dëshmitë sugjerojnë që kontributi i organizatave të shoqërisë civile për të drejtat e grave (OShCG) në ndryshimet shoqërore është thelbësor, megjithatë ka mungesë të të dhënave publike rreth kontributit të BE-së dhe të donatorëve të tjerë për barazi gjinore, e veçanërisht për OShCG. Për të adresuar këtë boshllëk informacioni, Kvinna till Kvinna mbështeti hulumtimin e kryer nga tetë OshCG të rajonit, udhëhequr nga [Rrjeti i Grave të Kosovës](#) (RrGK). Hulumtimi analizoi trendet e financimit të barazisë gjinore në Kosovë dhe Ballkanin Perëndimor (BP). Ky raport përmban rekomandime për BE-në, shtetet anëtare si dhe për donatorët, rekomandime këto veçanërisht të rëndësishme në kontekstin e anëtarësimit në BE. Hulumtimi u financua nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar.

Hulumtimi është kryer në vitin 2019 në të gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor me një metodologji të përzier, me kërkitime nga zyra, kërkesa për të dhëna si dhe intervista me **71 donatorë** e **241 OShCG**. Hulumtimi vë në pah se mjedisi i financimit në BP mbetet i **fragmentuar** me një bollëk të donatorëve të angazhuar, mirëpo rrallë herë të koordinuar. Shumica e fondeve që OShCG-të morën nga viti 2014 deri në mesin e vitit 2019 **buronin nga organizatat multilaterale (>21%) dhe ato bilaterale (>24%)**. Po ashtu, fondet e grave (11%) dhe organizatat joqeveritare ndërkombëtare (OJQN-të) (8%) siguruan burime të konsiderueshme për OShCG-të. Mbështetje më të vogël ofruan qeveritë (5%), fondacione të tjera përveç fondeve të grave (5%) dhe OJQ-të lokale (1%).

Disa nga gjetjet kryesore për Kosovën janë:

- Siç tregohet në raport, OShCG-të kanë dhënë kontribut të rëndësishëm në ndryshimet shoqërore në Kosovë. Duke përfshirë kontributin në ligje të reja, politika, ngritje të vetëdijes si dhe në ofrimin e shërbimeve thelbësore për ata më në nevojë.
- 16% e OShCG-ve në Kosovë nuk kanë pasur asnjëherë financim; ato punojnë në baza vullnetare.
- 86% e tyre raportuan se kishin periudha në të cilat nuk kishin fonde të mjaftueshme.
- Individët dhe bizneset ofrojnë pak fonde për OShCG-të në Ballkanin Perëndimor; ndryshimi i kornizës ligjore mund të mundësonte që individët dhe bizneset të japin më shumë.



- Krahasuar me qeveritë e rajonit, Qeveria e Kosovës dha më shumë fonde për OShCG-të, gjë e cila pjesërisht u atribuohet përpjekjeve për të përmirësuar njohuritë dhe praktikat e përdorimit të buxhetimit të përgjegjshëm gjinor në sektorë të ndryshëm. Sidoqoftë, financimi i qeverisë nuk është as i mjaftueshëm dhe as i qëndrueshëm, duke e vënë kështu në rrezik qëndrueshmërinë e OShCG-ve.
- Siç u shpreh një i anketuar, “Fondet afatgjata, veçanërisht nga ambasadat dhe qeveria do të ishin ideale, sepse janë më të sigurta.”
- Raporti arrin në përfundimin se për të siguruar fonde të qëndrueshme afatgjata për grupe të pavarura të të drejtave të grave, nevojitet dialog i mëtejshëm ndërmjet donatorëve, veçanërisht me qeverinë. Kjo në mënyrë që grupet e grave të vazhdojnë punën e tyre të rëndësishme. Aktivistët e të drejtave të grave duhet të jenë pjesë e këtyre diskutimeve.

Folës dhe diskutues në lansimin e raportit do të jenë: **Petra Tötterman Andorff**, Sekretare e Përgjithshme e Fondacionit Kvinna till Kvinna; **Nasrin Pourghazian**, Shefe e Bashkëpunimit për Zhvillim / Zëvendëse e Shefit të Misionit, Ambasada e Suedisë; **Edi Gusia**, Kryeshefe Ekzekutive, Agjencia për Barazi Gjinore në Kosovë; **Dario di Benedetto**, Koordinator i Ekipit për Zhvillim Social, Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë; **Nicole Farnsworth**, Drejtore e Programit dhe Udhëheqëse e Hulumtimit, RrGK; **Ulrika Richardson**, Koordinatore për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara, Ekipi i Kombeve të Bashkuara në Kosovë; **Liridona Sijarina**, Menaxhere e Projektit, Qendra Kosovare për Studime Gjinore (QKSGj) dhe **Igballe Rogova**, Drejtore Ekzekutive, RrGK. Në këtë lansim do të ketë edhe diskutim me publikun në formatin pyetje/përgjigje.

Raportin e plotë mund ta gjeni në: <https://kvinnatillkvinna.org/2020/06/01/wheres-the-money-for-womens-rights-2020/>.

Kurse raportin e plotë për Kosovën mund ta gjeni [KËTU](#).

Për më shumë informata rreth raportit, ju lutemi kontaktoni: Donjeta Morinën, Bashkëautore dhe hulumtuese (donjeta.m@womensnetwork.org).

Për më shumë informata rreth lansimit të raportit, ju lutemi kontaktoni: Sofija Vrbaski (sofija.vrbaski@kvinnatillkvinna.se).